

9.2 DRITARJA PËR KËRKIM

Për të kërkuar në bazën e njësuar të të dhënave CONOR hapet dritarja e ngjashme, sikurse për kërkim në bazat bibliografike të të dhënave.

Kërkimi - Regjistrimi i njësuar (CONOR)

Kërkimi i specializuar =>

Emri vetjak: kadare* AND

Emër organizate: AND

Organizata - shitesa/vendi i tak...: AND

Viti i takimit: AND

Pikëqasja njësuar - emër vetjak: AND

Kufizimi: Skanimi:

thyerja e rreshtit Formati i listës së rezultateve të kërkimit: Formati i paracaktuar Pyetësorët:

Nr. në vijim... CONOR.AL-ID Statusi dhe lloji i pikëqasjes së njësuar Pikëqasja e njësuar Variantet e pikëqasjes Pikëqasj... Gjuha

Nr. në vijim...	CONOR.AL-ID	Statusi dhe lloji i pikëqasjes së njësuar	Pikëqasja e njësuar	Variantet e pikëqasjes	Pikëqasj...	Gjuha
1	949606	a - emër vetjak, c - e përkohshme	Kadare, Iliriana			alb - shqipe
2	8673126	a - emër vetjak, a - e pranuar	Kadareja, K.			alb - shqipe
3	372070	a - emër vetjak, c - e përkohshme	Kadare, Helena	Kadare, Elena, 1943 (emër i vërtetë)		alb - shqipe
4	952934	a - emër vetjak, c - e përkohshme	Kadare, Shahin			alb - shqipe
5	1587302	a - emër vetjak, c - e përkohshme	Kadareja, Arjan			alb - shqipe
6	153190	a - emër vetjak, c - e përkohshme	Kadare, Kadrie	Kadare, K.		alb - shqipe
7	412774	a - emër vetjak, a - e pranuar	Kadare, Ismail			alb - shqipe
8	1953126	a - emër vetjak, a - e pranuar	Kadare, Besiana			alb - shqipe

Fund

Figura 9.2-1: Shembull i dritares për kërkim në bazën e të dhënave CONOR

Dritaren për kërkim mund ta hapni në shfletues ose në ndërfaqen për katalogim, d.m.th. në dritaren **Regjistrimi bibliografik** ose në dritaren **Regjistrimi i njësuar (CONOR)**.

Procedura

Ndërfaqja për katalogim.

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / CONOR**.

Hapet dritarja **Kërkimi – Regjistrimi i njësuar (CONOR)**.

Vazhdoni me procedurën e përshkruar në kap. 4.

Në pjesën e sipërme të dritares janë fushat për kërkim, përmes të cilave mund të kërkoni regjistrimet e anjësuar. Poshtë tyre, ashtu si edhe në dritaren për kërkim në bazat bibliografike të të dhënave, janë edhe fushat "Kufizimi" dhe "Skanimi".

Në pjesën e poshtme të dritares për kërkim shfaqen regjistrimet e njësuar, të cilat korrespondojnë me pyetjen për kërkim. Regjistrimet e përzgjedhura për t'u fshirë (001a = "d") dhe regjistrimet e përzgjedhur për t'u ndarë (001a = "r"), janë me ngjyrë hiri.

Teknika e kërkimit është e njëjtë me atë të kërkimit në bazat bibliografike të të dhënave. Kjo vlen për shkurtimin e pyetjes për kërkim, kërkimin përmes disa fushave dhe për sintaksën të kërkimi i avancuar dhe skanimit (shih kap. 4.1–4.3).

Veçoritë e tjera të kërkimit në dritaren për kërkim janë:

Indekset për kërkim

Lista e të gjitha indekseve për kërkim, që përdoren të kërkimi i avancuar në bazën e njësuar të të dhënave CONOR, është dhënë në shtojcën A.2.

Kërkimi me shenjat diakritike

Fushat për pikëqasjet, në indeksin shtesë janë të indeksuara me të gjitha shenjat diakritike, ndërsa në indeksin bazë janë edhe pa to, ngjashëm si fushat e tjera. Për këtë arsye, gjithmonë kur kërkoni me indeksin shtesë, duhet të shënoni saktë të gjitha shenjat diakritike.



Shembull:

Kërkoni me emrin e kompozitorit Georg Friedrich Händel.

Nëse të "Emër vetjak" shënoni *Händel, Georg Friedrich**, do të gjeni një regjistrim të njësuar. E njëjta pyetje për kërkim, por pa shenjën diakritike nuk jep asnjë rezultat. Nëse nuk dëshironi të shënoni shenjën diakritike në pyetjen për kërkim, regjistrimin për Händel mund ta gjeni vetëm përmes kërkimit të specializuar, nëse kërkoni me indeksin kryesor, pra duhet të shënoni: (*Handel and Georg and Friedrich*)/PN.